

Nr. Prot 010/



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

Nr. 6450/1 prot.

Tiranë, më 15.1. 2016

L Ë N D A: Kthim përgjigjeje

Z. Gjergj Erebara
BIRN ALBANIA

TIRANË

I nderuar Z. Erebara,

U njohëm me kërkesën Tuaj sipas shkresës nr.79 prot, datë 28.12.2015.

Paraprakisht, Ju falënderojmë për sensibilitetin që BIRN Albania shfaq për çështje kaq të rëndësishme, siç janë transparenca dhe informimi i publikut.

Transparenca dhe informimi i publikut janë vlerësuar maksimalisht nga Këshilli i Ministrave, i cili ka propozuar projektligjin përkatës, i miratuar tashmë, konkretisht ligji nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”. Ndër risitë e këtij ligji ishte dhe krijimi i institucionit të posaçëm të pavarur që ndjek zbatimin e tij si dhe krijimin/ngarkimin e strukturave përkatëse, në çdo autoritet publik, përgjegjëse për zbatimin e këtyre standardeve në këtë drejtim. Për monitorimin e këtij procesi, në ligj është parashikuar një organ i pavarur, i drejtuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Sa më sipër, në institucionin e Kryeministrisë janë marrë masat e nevojshme në zbatim të ligjit nr.119/2014, “Për të drejtën e informimit”, konkretisht, është caktuar koordinatori për të drejtën e informimit, i cili ka kryer trajnimet e nevojshme në bashkëpunim me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe është në përfundim miratimi i programit të transparencës. Për të qenë sa më transparent Këshilli i Ministrave ka realizuar me iniciativën e tij edhe një portal transparenca-al.

Referuar përmbajtjes së kërkesës, rezulton se çështjet e adresuara i përkasin publikimit të akteve të Këshillit të Ministrave. Në këtë kontekst, Ju kujtojmë se, në mbështetje të Kushtetutës, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të ligjit nr.78/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”, të gjitha aktet e miratuara në Këshillin e Ministrave, përjashtuar projektligjet, botohen në “Fletoren zyrtare”, e cila publikohet edhe në faqen zyrtare në internet të kësaj qendre. Në zbatim të plotë të këtyre detyrimeve, për periudhën që prej muajit shtator 2013 deri tani, nuk ka vendime të Këshillit të Ministrave të pabotuara në “Fletoren zyrtare” dhe faqen e saj zyrtare në internet.

Në këtë mënyrë, aktet e Këshillit të Ministrave publikohen përgjithësisht edhe në faqen e internetit të Kryeministrit, duke garantuar transparencën vendimmarrëse të Këshillit të Ministrave. Ndërsa, publikimi i të gjitha akteve të Këshillit të Ministrave në faqen zyrtare të Kryeministrit do të mundësohet plotësisht me miratimin e programit të transparencës.

Në aspektin ligjor, praktika dokumentare që shoqëron aktin deri në vendimmarrje nuk është pjesë përbërëse e tij, por konsiderohet si raportim i ministrit propozues për anëtarët e Këshillit të Ministrave. Dhe si të tilla, këto praktika dokumentare nuk janë publikuar në asnjë rast në “Fletoren Zyrtare”, faqen e saj zyrtare apo faqen zyrtare të internetit të Kryeministrit.

Referuar sa më sipër, edhe një herë ju falënderojmë për sensibilitetin e shfaqur ndaj kësaj çështjeje për të cilën Këshilli i Ministrave ka një vlerësim maksimal dhe gatishmëri për bashkëpunim për të pasur një transparencë dhe informim publik maksimal.

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKË E SHQIPËRI' at the top and 'KËSHILLI I MINISTRAVE' at the bottom, with a central emblem. The signature is written in a cursive style.